



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 383/25 Dt. 30.06.2025



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Raporti i punës së kryetarit – Janar-Qershor 2025

Të dashur qytetarë,

Teksa përmbylim gjysmën e parë të vitit 2025, ndihem thellësisht mirënjohës për mbështetjen dhe besimin tuaj të vazhdueshëm në punën që po bëjmë së bashku për ta zhvilluar dhe përmirësuar Komunën e Prizrenit. Ky rrugëtim që e nisëm para katër vitesh është shoqëruar me sfida, por mbi të gjitha me arritje konkrete dhe të prekshme në jetën e përditshme të qytetarëve tanë.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar projekte të rëndësishme infrastrukturore në të gjitha zonat e komunës, me theks të veçantë në rregullimin e infrastrukturës në lagjen Bazhdarhane, krijimin e hapësirave publike cilësore, përfshirë rehabilitimin e Shadërvanit, si dhe lirimin e shumë hapësirave të bllokuara më parë, duke mundësuar frymëmarrje të lirë për qytetin dhe qasje të barabartë për të gjithë.

Ngjarjet kulturore dhe ato sportive janë bërë tashmë pjesë e pandashme e jetës së qytetit tonë. Festivale, aktivitete për të rinjtë dhe mbështetje për klubet sportive po e kthejnë Prizrenin në një qendër dinamike dhe të gjallë, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Në të njëjtën kohë, kemi forcuar mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies në çdo nivel institucional. Komuna e Prizrenit ka shënuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha vlerësimet e organizatave që matin transparencën komunale, duke dëshmuar angazhimin tonë për t'u shërbyer qytetarëve me përgjegjësi dhe ndershmëri.

Të gjitha këto arritje janë rezultat i një pune të përbashkët dhe përkushtimi të pandërprerë për ta bërë Prizrenin një vend më të mirë për të jetuar. Ne kemi vendosur standarde të reja për zhvillimin lokal dhe kemi hedhur themele të forta për projekte të reja në muajt në vijim.

Faleminderit për besimin dhe partneritetin tuaj. Bashkë do të vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për qytetin tonë.

Prizreni në punë!

Shaqir Totaj





Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Më posht përmbledhen aktivitetet sistematike të realizuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Prizrenit gjatë periudhës janar–qershor 2025. Reflektohet puna në drejtim të koordinimit të qeverisjes komunale, bashkëpunimit ndërinstytucional, trajtimit të kërkesave qytetare dhe fuqizimit të marrëdhënieve me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Takimet me ekzekutivin dhe drejtoritë komunale

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takime të rregullta me drejtorët e Komunës me qëllim të vlerësimit të zbatimit të planit të punës, diskutimit të sfidave dhe vendimmarrjes së përbashkët në proceset qeverisëse. Përveç këtyre takimeve, janë zhvilluar takime shtesë me drejtori specifike dhe zyrtarë komunal për të diskutuar kërkesat dhe projektet prioritare në nivel sektorial.

Takimet me ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë

Zyra e Kryetarit ka pritur në takim ambasadorë të vendeve mike, për të forcuar bashkëpunimin bilateral dhe për të promovuar mundësi zhvillimi për Komunën e Prizrenit. Janë zhvilluar takime me ambasadorët e Turqisë, BE-së, Australisë (me seli në Kroaci dhe Kosovë), Gjermanisë dhe Francës.



Takimet me institucione vendore, qendrore dhe ndërkombëtare

Kryetari ka pritur përfaqësues të institucioneve të sigurisë, organizatave zhvillimore dhe shoqatave kombëtare. Këto takime kanë synuar nxitjen e bashkëpunimit institucional dhe identifikimin e fushave për ndërhyrje dhe përkrahje të ndërsjellë. Ndër partnerët institucionalë kanë qenë: KFOR-i, GIZ, UNDP, Peace Corps, Hidroregjioni Jugor, organizata të komuniteteve etnike, dhe institucione arsimore e kulturore.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Takimet me organizatat e shoqërisë civile

Zyra e Kryetarit ka qenë e hapur për bashkëpunim dhe dialog me organizatat e shoqërisë civile. Janë mbajtur takime të shumta me OJQ-të që veprojnë në fushat e të drejtave të njeriut, të rinjve, edukimit dhe mbrojtjes sociale. Këto takime kanë kontribuar në hartimin dhe zbatimin e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet.



Marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU)

Në kuadër të forcimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi:

- MoU me Agjencinë për Zhvillim Rajonal (AZHR)
- Marrëveshje me ekipin për prezantimin e Skemës së Granteve të WBF në partneritet me BE-në
- Nënshkrimi i kontratës me kompaninë “Ekoregjioni”
- MoU me GIZ dhe Makerspace
- Nënshkrimi i kontratës me “Ekoregjioni” për shërbimet e varrimit (në prani të KBI-së)
- MoU ndërmjet Projektit DEMOS të zbatuar nga HELVETAS dhe Komunës së Prizrenit
- MoU mes Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova
- Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e ndërtimit të objektit administrativ për nevojat e zeztarëve (Komuna e Prizrenit – MZHR)
- MoU me Policinë e Kosovës
- MoU mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- MoU me organizatën Concordia
- Marrëveshje trepalëshe mes Komunës, Policisë dhe Postës së Kosovës
- Marrëveshje me fondacionin “Halil Kastrati” për ndërtimin e kuzhinës popullore
- MoU me DEMOS për grantin e Performancës për projektin e Stacionit të Autobusëve
- MoU për Forumet e Komuniteteve për Energjinë e Efikase (FKEE)
- Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit “Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit”



Komunikimi me qytetarët dhe trajtimi i kërkesave

Zyra e Kryetarit ka pranuar dhe evidentuar gjithsej **117 kërkesa zyrtare** të adresuara nga qytetarë, OJQ, biznese dhe institucione të tjera. Një pjesë e këtyre kërkesave janë adresuar për zgjidhje në drejtoritë përkatëse, ndërsa të tjerat janë në shqyrtim brenda zyrës së Kryetarit.

Pjesëmarrja në aktivitete dhe inaugurime publike

Kryetari ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe zhvillimore, si dhe në inaugurimin e projekteve që përmirësojnë infrastrukturën dhe mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Prizrenit. Gjithashtu, janë zhvilluar takime me komunitetin e biznesit, përfaqësues të zejtarëve dhe profesionistëve lokalë.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2025, Njësia për Komunikim me Publikun ka vazhduar të mbajë standardet më të larta të profesionalizmit, etikës dhe integritetit në informimin e publikut dhe në shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të hartuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe njësitë e tjera administrative.

Janë përgatitur, lekturuar dhe përkthyer të gjitha njoftimet, thirrjet, vendimet dhe dokumentet zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës (shqip, boshnjakisht, turqisht dhe romisht). Publikimi i tyre është realizuar në kohë dhe sipas afateve ligjore në faqen zyrtare të komunës dhe në platformat sociale përkatëse.

Njësia ka bartur gjithashtu përgjegjësinë për organizimin profesional dhe ligjor të konsultimeve publike për dokumentet e hartuara nga kryetari, kuvendi dhe drejtoritë komunale. Në këtë periudhë janë organizuar shtatë takime publike me qytetarë në lokalitete të ndryshme në kuadër të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje për vitin 2026.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, së bashku me donatorët ndërkombëtarë si Bashkimi Evropian, Suedia dhe Zvicra, kanë shpallur Komunën e Prizrenit përfituese të grantit të performancës në vlerë prej 2,047,000 euro. Ky vlerësim është bërë në bazë të përmbushjes së indikatorëve të transparencës, respektimit të afateve ligjore dhe procedurave administrative.

Një tjetër arritje e rëndësishme është rangu i parë i Komunës së Prizrenit në transparencë dhe llogaridhënie ndër komunat e mëdha, sipas Transparometrit të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në prill 2025. Komuna ka përmbushur indikatorët në nivelin 98.96%.

Gjatë kësaj periudhe, Njësia për Komunikim me Publikun ka pranuar gjithsej 57 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat janë trajtuar brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe dokumentet e kërkuara janë ofruar në mënyrë të plotë dhe transparente.

Raporti i plotë me detaje të hollësishme mbi aktivitetet dhe rezultatet do të publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

2. ZYRA E PROKURIMIT

Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2025, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar dhe menaxhuar një sërë procedurash të prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke synuar transparencë, efikasitet dhe menaxhim të mirë të fondeve publike.

Deri më datën 13 qershor 2025, janë shpallur gjithsej 103 tenderë për punë, shërbime dhe furnizime, të ndara sipas kategorive të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha. Nga këto procedura, janë nënshkruar 65 kontrata për projekte të ndryshme, përfshirë edhe kontratat që kanë rezultuar nga procedurat e iniciuara në vitin 2024.

Po ashtu, janë nënshkruar 5 aneks-kontrata si vazhdim i kontratave bazë të vitit të kaluar, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e projekteve përkatëse.

Aktualisht janë në proces të hapjes apo të vlerësimit edhe 38 dosje të tjera të prokurimit, për të cilat pritet përmbyllja e procedurave në pjesën e dytë të vitit.

Për periudhën raportuese, janë regjistruar gjithsej 8 lëndë në proces të ankimimit për vitin 2025, të cilat po trajtohen nga organet kompetente në përputhje me procedurat ligjore.

Zyra e Prokurimit mbetet e përkushtuar në avancimin e praktikave të prokurimit publik, duke siguruar shërbime efikase dhe të përgjegjshme për të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative të Komunës së Prizrenit.

3. ZYRA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Lëndët e pranura dhe komunikimi zyrtar

Gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 03.06.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka pranuar gjithsej 902 kërkesa, të cilat janë shqyrtuar sipas procedurave përkatëse, ndërsa një pjesë e tyre janë ende në proces.

Numri i shkresave dhe komunikimeve elektronike gjatë kësaj periudhe ka qenë 1,131.

Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Civil

Gjatë gjashtëmujorit të parë janë shpallur 31 konkurse për nëpunës të shërbimit civil, për gjithsej 33 vende të lira pune. Rezultatet e tyre janë si më poshtë:



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- 5 konkurse kanë përfunduar me sukses, duke u plotësuar 6 vende pune;
- 9 konkurse kanë dështuar për shkak të mungesës së kandidatëve të suksesshëm;
- 1 konkurs është anuluar;
- 16 konkurse janë ende në procedurë.

Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Publik

Gjatë periudhës raportuese janë shpallur 13 konkurse për nëpunës të shërbimit publik, me gjithsej 77 vende të lira, të shpërndara sipas sektorëve:

- Në Shëndetësi:
 - 10 konkurse me 58 vende të lira – të gjitha janë aktualisht në procedurë.
- Në Arsim:
 - 3 konkurse me 19 vende të lira, prej të cilëve:
 - 2 konkurse me 16 vende të lira kanë përfunduar me 5 persona të pranuar;
 - 1 konkurs me 3 vende të lira është në procedurë.

Konkurset për Nëpunës Teknik dhe Mbështetës

Gjatë kësaj periudhe është shpallur 1 konkurs me 6 vende të lira, i cili ka përfunduar me 5 persona të pranuar.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore mbetet e angazhuar në zbatimin e standardeve ligjore dhe administrative për menaxhimin e resurseve njerëzore, duke garantuar transparencë, barazi dhe efikasitet në të gjitha proceset e rekrutimit dhe trajtimit të kërkesave administrative.

4. ZYRA LIGJORE

Në bazë të kompetencave ligjore dhe obligimeve funksionale të njësisë, gjatë periudhës raportuese janar–qershor 2025 janë hartuar dhe proceduar për nënshkrim nga Zyra e Kryetarit të Komunës gjithsej **258 vendime** dhe **5 autorizime**.

Shpërndarja mujore e vendimeve dhe autorizimeve është si më poshtë:

- Në muajin janar janë përgatitur 67 vendime;
- Në muajin shkurt janë përgatitur 57 vendime dhe 2 autorizime;
- Në muajin mars janë përgatitur 39 vendime dhe 2 autorizime;
- Në muajin prill janë përgatitur 35 vendime dhe 1 autorizim;



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Në muajin maj janë përgatitur 46 vendime, pa autorizime;
- Në muajin qershor (deri më 04.06.2025) janë përgatitur 14 vendime, pa autorizime.

Kjo njësi ka vazhduar me efikasitet dhe saktësi zbatimin e procedurave administrative për hartimin dhe përcjelljen e vendimeve dhe autorizimeve, në përputhje me dispozitat ligjore dhe afatet kohore për veprim institucional.

5. ZYRA E PËRFAQËSUESIT LIGJOR

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka përfaqësuar dhe mbrojtur interesin e Komunës dhe institucioneve vartëse në procedura gjyqësore civile, administrative dhe përmbarimore në të gjitha nivelet e gjyqësorit.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar mbi 100 lëndë të reja dhe janë shqyrtuar mbi 120 akte gjyqësore, kryesisht nga Gjykata Themelore. Janë hartuar mbi 80 përgjigje ndaj padive dhe është siguruar përfaqësim në mbi 140 seanca gjyqësore.

Shumica e vendimeve kanë qenë në favor të Komunës, ndërsa në disa raste, çështjet janë kthyer për rigjykim pas ankesave të paraqitura nga Zyra. Janë ushtruar ankesa dhe mjete të jashtëzakonshme në gjykatat kompetente.

Zyra ka bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë komunale përmes komunikimeve zyrtare dhe ofrimit të mendimeve ligjore.

Zyra ka realizuar me profesionalizëm detyrat ligjore dhe mbetet e angazhuar në mbrojtjen efikase të interesave të Komunës së Prizrenit.

6. ZYRA PËR ÇËSHTJE PRONËSORO-JURIDIKE

Gjatë periudhës janar-qershor 2025, Sektori për Çështje Pronësor-Juridike ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të lëndëve administrative dhe juridike, që lidhen me shfrytëzimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e pasurisë së komunës.

Janë pranuar dhe proceduar lëndë që kanë të bëjnë me shpronësimet, kontratat e qirasë për pronat komunale, vërtetimin e uzurpimeve të tokës si dhe kërkesa të ndryshme nga institucionet e brendshme dhe të jashtme.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Shumica e lëndëve të pranuara janë shqyrtuar brenda afateve ligjore dhe janë përmbyllur me aktvendime përkatëse. Një pjesë e tyre është në procedurë e sipër, ndërsa një numër është refuzuar, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Lëndët kanë përfshirë:

- Procedura të shpronësimit dhe bartjes administrative;
- Anulime të aktvendimeve mbi shpronësim;
- Përpilim dhe kontroll të kontratave të qirasë për pronat komunale;
- Vërtetim të uzurpimeve arbitrare të tokës;
- Kërkesa të ndryshme për informim dhe përfaqësim institucional.

Në këtë periudhë është vërejtur një rritje e kërkesave për trajtim të çështjeve që lidhen me pronësinë, qiranë dhe vërtetimin e gjendjes juridike të parcelave dhe objekteve në pronësi të Komunës.

Spektori ka bashkëpunuar ngushtë me Avokaturën Publike Komunale, Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorinë e Inspektorateve dhe me Shërbimin Policor të Kosovës, në funksion të zgjidhjes sa më efikase të lëndëve.

Spektori për Çështje Pronësoro-Juridike ka realizuar detyrat me përkushtim dhe në përputhje me ligjin, duke kontribuar në funksionimin e rregullt administrativ dhe juridik të Komunës së Prizrenit.

Monitorimi i investimeve në prona komunale – Vlerësimi i dy subjekteve private

Në kuadër të angazhimit të Komunës për mbikëqyrje transparente dhe të vazhdueshme të shfrytëzimit të pronës publike, me vendim të Kryetarit të Komunës është themeluar Komisioni për Inspektimin e Ndërmarrjeve që kanë kontratë për shfrytëzimin e pronave komunale me afat të gjatë. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Komisioni ka përfunduar inspektimet për dy subjekte ekonomike: “Fatoni 1” SHPK dhe “Kamilla” SHPK.

Kompania “Fatoni 1” SHPK

Pas shqyrtimit të faturave, fletëpagesave dhe vizitës në terren, Komisioni ka konstatuar se kompania “Fatoni 1” SHPK ka realizuar investime në përputhje me planin dinamik të miratuar, duke arritur një shumë të përgjithshme të investimeve prej 532,037.11 euro. Kjo shumë përfaqëson një përmbushje të konsiderueshme të planit, i cili ka afat zbatimi deri në fund të vitit 2026 dhe parasheh një vlerë totale investimi prej 700,000 euro.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Gjithashtu, objekti ndërtimor është realizuar në përputhje me lejen ndërtimore dhe specifikimet teknike, ndërsa sipas verifikimit nga Sektori i Pronës, kompania ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale në lidhje me pagesën e qirasë deri më datën 27.05.2025. Kjo përbën një rast pozitiv të bashkëpunimit mes sektorit publik dhe atij privat, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimit të drejtë të pronës komunale.

Kompania “Kamilla” SHPK

Në anën tjetër, për kompaninë “Kamilla” SHPK, Komisioni ka konstatuar se investimet e kryera janë në nivel dukshëm më të ulët se sa parashikimi në kontratë. Deri më datën 28.05.2025, kjo kompani ka prezantuar fatura dhe dëshmi për investime në vlerë prej 52,370.80 euro, ndërkohë që vlera e planifikuar e investimit ka qenë 100,000 euro, me afat realizimi deri në qershor të vitit 2024.

Edhe pse pagesat e qirasë janë përmbushur sipas kontratës, Komisioni ka hasur në vështirësi për të bërë një vlerësim të plotë, pasi përfaqësuesit e kompanisë kanë deklaruar se një pjesë e madhe e investimeve janë kryer para nënshkrimit të kontratës, por nuk kanë qenë në gjendje të paraqesin dokumentacion të plotë dhe të verifikueshëm që dëshmon këtë.

Për këtë arsye, investimi është konsideruar i papërmbushur, dhe në raport është shënuar se nuk ka pasur mundësi të jepet një vlerësim real për arritjen e objektivave të kontratës.

Në përmbyllje, vlen të theksohet se ky proces i monitorimit është pjesë e angazhimit të Kryetarit dhe administratës komunale për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e pasurisë publike, si dhe për të siguruar që investimet private në pronë komunale të përkthehen në zhvillim të qëndrueshëm për qytetarët e Prizrenit.

7. ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDËSHËM

Objektivat kryesore:

- Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme;
- Realizimi i 6 detyrave audituese sipas planit të vitit 2025 dhe 2 raporte për rishikimin e rekomandimeve;
- Raportimi te Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit dhe Njësia Qendrore Harmonizuese pranë Ministrisë së Financave;



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), mbajtja e 4 takimeve me Komitetin e Auditimit dhe këshillimi i stafit komunal.

Rezultatet kryesore:

- Finalizim i 2 raporteve audituese dhe 1 raport rishikimi rekomandimesh;
- Një auditim në proces (menaxhimi i pasurisë jo financiare në administratë dhe drejtoritë e shëndetësisë dhe arsimit për vitet 2023/2024).

Detyrat e kryera:

1. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2024 – 1 rekomandim;
2. Auditimi i rregullsisë në subvencione dhe transfere – 4 rekomandime;
3. Auditimi i planifikimit dhe inkasimit të të hyrave nga taksat komunale – 1 rekomandim;
4. Auditimi i performancës në menaxhimin e pasurisë – në proces.

Aktivitete shtesë:

- Koordinim me ZKA për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2024;
- Përgatitje e raporteve vjetore dhe raportimi në janar 2025;
- Mbajtja e dy takimeve me Komitetin e Auditimit;
- Pjesëmarrje në takime dhe punëtori në kuadër të Projektit DEMOS dhe aktivitete këshilluese për drejtorët dhe zyrtarët komunalë.

Në përmblendje, Zyra e Auditimit të Brendshëm ka realizuar me sukses aktivitetet e parashikuara për gjysmën e parë të vitit 2025, duke siguruar monitorim efektiv dhe përmirësim të proceseve në administratën komunale.

8. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Gjatë kësaj periudhe, Zyra ka koordinuar dhe raportuar mbi zbatimin e obligimeve të komunës nga Agjenda Evropiane dhe Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë dhe sipas kërkesave të MAPL-së.

Është monitoruar dhe zbatuar projekti i Këshillit të Evropës “Forcimi i Qeverisjes në shumë nivele”, duke organizuar dy aktivitete me fokus në qeverisje pjesëmarrëse dhe të hapur.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Zyra ka ndjekur trendin e migrimit pas liberalizimit të vizave dhe ka raportuar përkatësisht në MAPL.

Ka marrë pjesë në komisione dhe grupe punuese komunale për: riintegrimin e të riatdhesuarve, barazinë gjinore, transparencën, integritetin institucional, sigurinë në shkolla dhe auditimin e brendshëm.

Gjithashtu, ka qenë aktive në takimet e Kolegjiumit për Integritet Evropian dhe Komitetin për Qeverisje të Hapur, si dhe ka marrë pjesë në sesione informuese dhe trajnime të programeve të BE-së.

9. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM, PRIZREN

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Prizren, themeluar në vitin 2000 dhe pjesë e Komunës, ka për qëllim integrimin e komuniteteve minoritare në të gjitha fushat e jetës.

Objektivat kryesore: ngritja e mirëqenies së komuniteteve minoritare, kthimi i personave të zhvendosur, qëndrueshmëria, siguria, riintegrimi i të riatdhesuarve, bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare, shëndetësia, arsimi, ngjarjet kulturore dhe fetare, si dhe organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Veprimtaria kryesore gjatë periudhës:

- **Mirëqenia e komuniteteve minoritare:**
Shpërndarje pakove ushqimore dhe veshmbathjes për familje në nevojë nga komunitetet Boshnjak, Turk, Rom, Ashkali dhe Egjiptian; nisja e ndarjes së subvencioneve për ngrohje dhe pakove ushqimore për familjet skamnore; bashkëpunim me Shoqatën BEREQETI; formim i kolegjiumit të ZKKK-ve në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
- **Kthimi i personave të zhvendosur:**
Informim dhe asistim i personave të zhvendosur për procesin e kthimit dhe dokumentacionin e nevojshëm; vizita dhe verifikim i familjeve në Serbi dhe brenda Kosovës; pranim i kërkesave për kthim.
- **Qëndrueshmëria:**
Mbajtje e takimeve për inkurajimin e përfshirjes së riatdhesuarve dhe komuniteteve në aktivitete lokale; njoftime për thirrje publike dhe ofrim shërbimesh transporti.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Siguria:
Pjesëmarrje aktive në mbledhjet e KKSBB-së dhe monitorim i rehabilitimit të objekteve të dëmtuara nga zjarri.
- Riintegrimi i personave të riatdhesuar dhe integrimi i të huajve:
Trajtim i kërkesave për akomodim dhe sigurim i ndihmave ushqimore dhe për ngrohje në bashkëpunim me institucionet kompetente.
- Bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare:
Bashkëpunim i vazhdueshëm me OSBE, UNHCR, UNMIK, IOM dhe të tjera; nënshkrim i marrëveshjeve për plane biznesi dhe furnizim me pajisje për shkolla dhe komunitete.
- Shëndetësia:
Lëshim i 306 vërtetimeve për trajtim jashtë vendit.
- Ngjarjet fetare dhe kulturore:
Monitorim i aktiviteteve të komunitetit ortodoks dhe bashkëpunim për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse.
- Trajnimet, punëtoritë dhe aktivitete të tjera:
Vizita në terren dhe ndihmë për familje në gjendje të rëndë; pjesëmarrje në takime dhe punëtori me institucione dhe organizata; shqyrtim i kërkesave për projekte të ndryshme dhe bashkëpunim me drejtoritë komunale.

Në përgjithësi, Zyra ka funksionuar aktivisht në përmbushjen e objektivave të saj, duke siguruar mbështetje për komunitetet minoritare dhe duke forcuar proceset e kthimit dhe riintegritimit në Komunën e Prizrenit.

1. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka vazhduar me realizimin e projekteve infrastrukturore të planifikuara, përfshirë projekte të bartura nga vitet paraprake dhe projekte të reja në realizim. Janë nënshkruar kontrata të reja, janë përmbyllur dhjetëra projekte dhe është bërë përgatitja për nisjen e dhjetëra të tjerave.

Buxheti total për investime kapitale për vitin 2025 është rreth 13.5-milionë euro, ndërsa për mallra dhe shërbime janë ndarë mbi 5.2-milionë euro. Nga të hyrat e bartura të vitit 2024 janë siguruar edhe 654 mijë euro shtesë për financimin e obligimeve kontraktuale dhe projekteve të vogla.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Gjatë kësaj periudhe:

- Janë nënshkruar 10 kontrata të reja në vlerë mbi 11.4 milionë euro.
- Janë shpenzuar rreth 8.4 milionë euro për investime kapitale dhe 2.7 milionë euro për mallra dhe shërbime.
- Janë zhvilluar procedura për mbi 10 projekte të reja, dhe janë marrë 10 vendime për fillimin e procedurave.



Disa prej projektet më të rëndësishme në realizim ose të përfunduara infrastrukturore:

- Ndërtimi i rrugës tranzitore (kryqëzim me autostradën) – projekt dyvjeçar
- Rehabilitimi i rrugës “Nëna Terezë” dhe rrjetit të ujësjellësit – projekt dyvjeçar
- Ndërtimi i kanalizimit dhe mureve mbrojtëse në Krushë e Vogël – projekt dyvjeçar
- Rehabilitimi i hapësirave publike në pjesën e vjetër të qytetit – dy projekte: një dyvjeçar dhe një trevjeçar
- Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu – projekt dyvjeçar
- Ndërtimi i rrugës alternative Skorrobisht–Lubizhdë
- Ndërtimi i infrastrukturës në: **Jabllanicë, Grazhdanik, Korishë, Kobajë, Romajë, Tusus, Gjonaj, Lubizhdë, Dardania 2 (Lot 1–3), zona “11 Marsi”**
- Ndërtimi i rrugës Billushë – Zhur – projekt dyvjeçar
- Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugëve në Skorrobisht – projekt dyvjeçar
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Zhur dhe Lubizhdë
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në disa zona urbane dhe rurale
- Ndërtimi i rrugës me asfalt dhe murit mbrojtës në Manastiricë – projekt trevjeçar



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Ndërtimi i rrugës te shkolla në Novosellan
- Ndërtimi me kalldrëm i rrugës te kulla në Jeshkovë – projekt dyvjeçar
- Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen e re te shkolla në Dardani
- Ndërtimi i rrugës dhe kanalizimit në lagjen Ortakoll, rr. Ali Hadri, Hajdar Shala, Marie Shllaku, Faik Konica, Rexhep Kukaj etj.



Ndërtimi i urave dhe mure mbrojtëse:

- Urat në Poslisht, Velezhë (dy ura) dhe Korishë – **në përfundim e sipër**
- Mure mbrojtëse të përfunduara në 20 lokalitete, përfshirë: Pllanjanë, Billushë, Korishë, Skorrobisht, Gërçar, Poslisht, Bajram Curr, Neprogosht, Landovicë, Jeshkovë, Shatërvan, Malësi e Vrrinit, Reqan, Krushë e Madhe, Leskovec, etj.

Projekte të tjera të realizuara:

- Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në mbi 16 rrugë dhe 151 lokacione
- Piketimet dhe matjet gjeodezike në terren sipas kërkesave të drejtorive
- Legalizimi i 134 objekteve në bazë të vendimeve të Drejtorisë së Urbanizmit

Sektori i Menaxhimit të Mjedisit dhe Mbeturinave



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Sektori i Menaxhimit të Mjedisit dhe Mbeturinave ka implementuar kontrata për:

- Menaxhimi i mbeturinave (grumbullim, transport dhe deponim)
- Riparim dhe mirëmbajtje të rrugëve në zonat I, II dhe III
- Pastrim të pikave ilegale të mbeturinave – **80 ton të grumbulluara**
- Ndërtimi dhe rehabilitimi i miniparqeve në Lakuriq, Bazhdarhane, Ortakoll
- Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit – **projekt trevjeçar**
- Mbjellja e 1,100 drunjve dekorativë, 2,200 shkurreve dhe barishtje në 3,400 m²
- Krasitja e 223 drunjve dhe prerja e drunjve të tharë në zona të ndryshme urbane



Drejtoria e Shërbimeve Publike ka realizuar një volum të madh pune gjatë periudhës janar–qershor 2025, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës, mjedisit dhe kushteve të jetesës në Komunën e Prizrenit. Realizimi i projekteve të planifikuara ka qenë në përputhje me objektivat strategjike dhe me përkushtim të plotë për shërbim cilësor ndaj qytetarëve.

2. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Aktivitete Kryesore të Realizuara:

- Përrurimi i Varrezave të Martirëve në Krushën e Vogël
- Blerja e 7 veturave të reja për nevojat e Komunës
- Mbështetja e organizimit të Epopeve dhe aktiviteteve përkujtimore
- Furnizimi me dru dhe pelet për të gjitha objektet komunale
- Mbështetje për organizatat e dala nga lufta



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Fillimi i ekzekutimit të pagesave për kryetarët e bashkësive lokale

Sektori i Gjendjes Civile:

- Janë lëshuar gjithsej 66,451 certifikata, përfshirë:
 - 32,378 ekstrakte lindjeje
 - 12,698 certifikata lindjeje
 - 7,317 certifikata martese
 - 3,504 certifikata vdekjeje
- Janë kryer gjithsej 2,750 shërbime me procedurë, duke përfshirë:
 - 1,155 regjistrime të lindjes
 - 559 regjistrime martese
 - 351 regjistrime vdekje
 - 204 vendime për ndërrime dhe korrigjime të të dhënave

Sektori i Teknologjisë Informative (IT):

- Janë realizuar mbi 450 intervenime teknike, përfshirë:
 - 130 formatizime dhe instalime të sistemeve operative
 - 90 hapje përdoruesish dhe e-mail zyrtar
 - 75 konfigurime të kompjuterëve të rinj dhe integrim në domenin qeveritar
 - 50 përditësime në uebfaqe, intranet dhe platforma komunale
 - Mbështetje për zyrtarët komunalë dhe institucionet me mungesë staf IT

Zyra për Barazi Gjinore:

- Organizim i trajnimeve për zyrtarë komunalë dhe kryetarët/et e bashkësive lokale
- Fillimi i procesit të botimit të gazetës “Barazia në Fokus” – platformë informuese për barazinë gjinore
- Promovim i historive të suksesit dhe analizë mbi gjendjen gjinore në Komunë

3. DREJTORIA PËR EMERGJENCË DHE SÏGURI

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe ndërhyrjesh me qëllim rritjen e sigurisë publike dhe përmirësimin e kushteve të operimit për shërbimet e emergjencës.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Projektet e realizuara përmes prokurimit:

- Blerja e një droni për Brigadën e Zjarrfikësve për ndërhyrje dhe monitorim të zonave të rrezikuara,
- Pajisje shtesë për nevojat operative të Brigadës së Zjarrfikësve,
- Blerja e uniformave të reja për Shërbimin e Zjarrfikësve.



Projektet në vazhdim:

- Faza e dytë e vendosjes dhe mirëmbajtjes së kamerave të sigurisë përgjatë unazës së qytetit dhe në segmentin nga Qafa e Kishës deri te qendra tregtare Elkos,
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zona të prekura nga rrëshqitjet e dheut për mbrojtjen e banorëve dhe infrastrukturës.

Statistika të intervenimeve nga Brigada e Zjarrfikësve:

- Numri i zjarreve të shuar: 588 raste,
- Intervenime teknike (aksidente, ndihmë teknike etj.): 155 raste,
- Verifikim teknik i sigurisë: hidrante dhe ashensorë në objekte publike dhe private si Spitali Rajonal, PTK, KEK, shkolla, qendra tregtare etj.

Aktivitetet e Inspektorëve të Preventivës:

- Pëlqime për kushte të sigurisë: 24,
- Hulumtime në kushte minimale teknike: 3,



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Hulumtime me përpilim të procesverbaleve: 2,
- Zjarre të inspektuara dhe të evidentuara: 7.

4. DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA

Drejtorja për Ekonomi dhe Financa është përgjegjëse për planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e resurseve financiare të Komunës së Prizrenit. Struktura organizative e kësaj drejtorie përbëhet nga katër sektorë:

1. Sektori për Buxhet dhe Thesar
2. Sektori i Financave
3. Sektori për Tatim në Pronë
4. Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve

BUXHET DHE THESAR – JANAR – MAJ 2025	
Pagesat e ekzekutuara	1420
Zotimet e bëra për pagesë	758
Pranimi i mallit në SIMFK	779
Aprovimi i lëndëve për mjetet e zotuar dhe të pranimi të mallit	2489

Ky sektor ka pasur angazhim të vazhdueshëm në realizimin e pagesave, pranimin e mallit dhe menaxhimin e zotimeve në sistemin financiar SIMFK.

TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE SIPAS DREJTORIVE PËR PERIUDHEN JANAR – MAJ 2025

Kodi	Drejtorit	Planifikimi	Të Hyrat	Diferenca	Indexi
16310	Administrata dhe Personeli	475,000.00	163,125.52	-311,874.48	34.34%
16619	Inspekcioni	40,000.00	13,393.70	-26,606.30	33.48%
17510	Ekonomi,Financ dhe Zhvillim	3,100,777.00	1,548,861.6 2	-1,551,915.38	49.95%
18010	Shërbime Publike,Mbrojtje civile, emergjenca	3,615,000.00	1,789,257.9 6	-1,825,742.04	49.49%



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

47010	Bujqsi,Pylltari dhe Zhvillim Rural	0.00	17,335.28	17,335.28	0.00%
65050	Kataster dhe Gjeodezia	470,000.00	117,610.00	-352,390.00	25.02%
66055	Planifikim Urban dhe Mjesdisi	2,190,000.00	778,140.86	-1,411,859.14	35.53%
73600	Shërbimet e kujdesit primar Shëndetsor	230,000.00	116,592.30	-113,407.70	50.69%
85010	Kultur, Rini, Sport	10,000.00	1,415.20	-8,584.80	14.15%
92050	Arsimi dhe Shkencë-Administrata	470,000.00	105,121.00	-364,879.00	22.36%
	Gjithësej	10,600,777.00	4,650,853.44	-5,949,923.56	43.87%

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar – Maj 2025 është siç shihet edhe në tabelën e prezentuar më lartë: Për vitin 2025 janë planifikura të hyra 10,600,777.00 € kurse për këtë periudhë janë mbledhur të hyra vetanake 4,650,853.44 € apo 43.87 % nga planifikimi.

RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE – JANAR – MAJ 2025

Komuna e Prizrenit - Drejtoria për Buxhet dhe Financa				
Shpenzimet sipas Kategorive	periudha 01.01.2025-31.05.2025			
Kategoria	Planifikimi	Shpenzimet	Diferenca	Indexi (%)
Pagat	27,513,732.00	11,889,857.34	-15,623,874.66	43.21%
Mallrat dhe Shërbimet	14,247,700.38	6,582,228.46	-7,665,471.92	46.20%
Shpenzimet Komunale	1,055,298.70	444,726.98	-610,571.72	42.14%
Subvencionet	4,642,712.78	1,280,996.79	-3,361,715.99	27.59%
Shpenzimet Kapitale	23,104,277.11	12,798,275.81	-10,306,001.30	55.39%
Gjithësej	70,563,720.97	32,996,085.38	-37,567,635.59	46.76%

QENDRA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Regjistrimet e reja	439
Ndryshimet	288
Shuarjet	42
Rez. Emrit	/
Informatat e biznesit	345
Njoftim mbi shuarjen	1
Historiku	/
Duplikat	45
Vërtetime	28
Tjera	/
Ndërrim çertifikate (NUI)	42

TATIMI NË PRONË

Shtypja dhe shpërndarja e faturave	33,757
Të hyrat nga Tatimi në Pronë	1,548,861.62
Regjistrimet e objekteve	1,407
Verifikimi i objekteve ekzistuese	3,833
Ankesat e pranuar për pronën e paluajtshme	499

Ky sektor ka qenë aktiv në përmirësimin e të dhënave kadastrale dhe ofrimin e shërbimeve për tatimpaguesit.

5. DREJTORIA E INSPEKTORATEVE

Sektori i Tregut

Sektori i Tregut është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit dhe zbatimin e ligjeve që rregullojnë aktivitetet tregtare në qytet dhe periferi. Gjatë këtij gjashtëmujori janë inspektuar mbi



Republika e Kosovës


Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

620 biznese, duke përfshirë qendra tregtare, dyqane zejtare, biznese hoteljere dhe tregtare të ndryshme. Inspektimet fokusohen në:

- Kontrollin e çmimeve (vendosja, ekspozimi dhe harmonizimi i tyre mes rafteve dhe arkës).
- Verifikimin e peshës dhe cilësisë së produkteve, sidomos në furrat e bukës ku pesha e bukës është matur dhe krahasuar me deklarimet.
- Vendosjen e flamujve të origjinës së produkteve pranë çmimeve, në përputhje me ligjin.
- Kontrollin e deklaracioneve në gjuhën shqipe në produktet e ndryshme, duke përfshirë barnat dhe artikujt teknikë.
- Trajtimin dhe shqyrtimin e reklamacioneve të konsumatorëve; gjatë periudhës janë trajtuar 12 raste ankesash.
- Tërheqjen dhe asgjësimin e artikujve të pasigurt, me vlerë totale mbi 58,000 euro, për shkak të afatit të skaduar ose rrezikut për konsumatorin.
- Bashkëpunimin e ngushtë me Policinë dhe Prokurorinë për inspektime në lokale nate, transport mallrash, dhe raste të tjera specifike që kërkojnë ndërhyrje ligjore.
- Kontrollin e shitjes së duhanit, pijeve alkoolike dhe energjike, me fokus të veçantë në respektimin e ndalimit për personat nën 18 vjeç, ku janë inspektuar rreth 100 biznese në qytet dhe periferi.
- Inspektimin e barnatoreve për dokumentacionin ligjor, vendosjen e çmimeve dhe deklaracioneve në gjuhën shqipe.





Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Sektori i Ndërtimit

Sektori i Ndërtimit monitoron dhe kontrollon zbatimin e standardeve teknike dhe ligjore në fushën e ndërtimit dhe materialeve ndërtimore. Gjatë këtij gjashtëmujori janë realizuar inspektime të ndërmarrjeve që merren me prodhimin dhe shitjen e materialeve ndërtimore, si dhe të bizneseve që importojnë produkte të tilla. Fokuset kryesore janë:

- Verifikimi i atesteve dhe certifikatave të cilësisë së materialeve ndërtimore, duke siguruar përputhshmërinë me standardet vendore dhe ndërkombëtare.
- Kontrolli i qëndrueshmërisë së produkteve ndaj kushteve klimatike dhe përdorimit në ndërtim.
- Inspektimi i kushteve ligjore dhe dokumentacionit të ndërmarrjeve, përfshirë lejet e punës dhe pëlqimet për ushtrimin e veprimtarive afariste në fushën e ndërtimit.
- Mbikëqyrja e sigurisë dhe respektimit të kushteve teknike gjatë punës në ndërtim, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe rreziqeve për punëtorët dhe qytetarët.

Sektori Komunal

Sektori Komunal është përgjegjës për zbatimin e rregullave komunale që lidhen me mjedisin urban dhe shërbimet komunale, duke siguruar rendin dhe pastërtinë në hapësirat publike dhe private. Gjatë periudhës janar-qershor janë kryer inspektime të shumta në:

- Kontrollin e pastrimit dhe menaxhimit të mbeturinave nga bizneset dhe komuniteti, duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit urban dhe shëndetit publik.
- Monitorimin dhe parandalimin e ndotjes së zhurmës dhe shqetësimeve të tjera që prekin qetësinë publike.
- Verifikimin e respektimit të rregullave për ekspozimin dhe funksionimin e bizneseve që ndikojnë në ambientin komunal, përfshirë kafiteritë, kiosqet dhe aktivitetet e tjera tregtare.
- Bashkëpunimin me sektorët tjerë të inspektorateve (Ndërtimi, Tregu, Mjedisi, Komunikacioni) për zgjidhjen e problemeve të ndërkufizuara dhe për zbatimin e ligjeve në mënyrë të koordinuar dhe efikase.
- Inspektimin e kushteve në transportin publik dhe transportin e mallrave, në bashkëpunim me inspektorin e komunikacionit, duke kontrolluar dokumentacionin, faturat dhe lejet për veprimtaritë e transportit.
- Veprime në përputhje me ligjet dhe urdhrat e Drejtorit të Inspektorateve për parandalimin e shkeljeve dhe rregullimin e situatave të pazgjidhura që ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në të gjitha sektorët, puna e inspektorëve mbështetet në ligjet dhe rregulloret në fuqi, dhe realizohet me përkushtim për të garantuar rendin, sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe konsumatorëve në Komunë.

6. DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Raporti i punës së DKSH për periudhën janar-maj 2025

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë gjatë periudhës janar – maj 2025 ka realizuar një sërë aktivitesh dhe punësh të rëndësishme, si në fushën e investimeve kapitale, ashtu edhe në furnizimin me mallra dhe shërbime shëndetësore. Përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), janë ofruar një numër i konsiderueshëm shërbimesh shëndetësore për qytetarët e komunës.

Në fillim të periudhës janë ndërmarrë të gjitha hapat për inicimin e procedurave për realizimin e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2025. Nga investimet kapitale në vazhdimësi janë:

1. Ndërtimi i QKMF-së te ish-kampi i KFOR-it.
2. Ndërtimi i QMF-së në Lagjen Tusuz.

Për projektet e tjera kapitale, si ndërtimi i Ambulancës në fshatrat Vlashnje dhe Randobravë, blerja e autoambulancave dhe paisjeve mjekësore, stomatologjike, laboratorike dhe jomjekësore, janë iniciuar procedurat e nevojshme, me pritje që të përfundojnë brenda këtij viti. Për furnizimin me mamograf është nënshkruar kontrata dhe pritjet realizimi i saj sipas kushteve kontraktuale.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi



Në fushën e mallrave dhe shërbimeve janë ndërmarrë prokurimet për:

- Furnizim me reagenca laboratorike, filma RTG, materiale higjienike, barna dhe materiale sanitare.
- Furnizim me materiale administrative dhe uniforma pune për personelin shëndetësor.
- Trajnime për profesionistët shëndetësorë për avancimin e kapaciteteve dhe shërbimeve ofruese.





Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Për disa prej këtyre kategoriave, furnizimet janë realizuar në vazhdimësi sipas kontratave aktive të vitit të kaluar, për të mbuluar nevojat e përditshme të institucioneve shëndetësore.



Gjatë kësaj periudhe, QKMF-ja ka ofruar rreth 385,875 shërbime shëndetësore, duke përfshirë: vizita specialistike, vaksinime, analiza laboratorike, radiografi (RTG), shërbime urgjente, geriatrike dhe paliative, shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, teste rapide, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime dhe udhëzime të ndryshme.

Në këtë periudhë ka përfunduar realizimi i vizitave sistematike mjekësore në shkolla, për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9 në Komunën e Prizrenit, ndërsa drejtorja ka marrë pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve për shënimin e Ditëve Botërore të shëndetit, duke përfshirë ligjërata, shpërndarje fletushkash dhe aktivitete në Sheshin Shadërvan. Ditët e shënuara përfshijnë:

1. Dita Botërore e Kancerit
2. Dita Botërore e Tuberkulozit
3. Java Botërore e Imunizimit
4. Dita Botërore e Hipertensionit
5. Dita Botërore e Duhanit

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka nisur pranimi i aplikacioneve për mbështetje financiare sipas rregullores për ndarjen e subvencioneve. Nga muaji shkurt deri në fund të majit 2025 janë paraqitur 832 kërkesa për mbështetje financiare, ku deri tani janë realizuar pagesa për 247



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

kërkesa në vlerë prej 98,800 eurosh. Përveç kësaj, janë kryer pagesa edhe për 187 kërkesa të pranuar gjatë vitit 2024, që për shkak të mungesës së mjeteve financiare u realizuan në vitin 2025, me një vlerë totale prej 74,800 eurosh.

Në këtë periudhë janë realizuar vizita monitoruese në QMF-të në Korishë, Lubizhdë, Romaj dhe disa qendra të tjera shëndetësore, si dhe në vendin ku po ndërtohet QKMF-ja e re, së bashku me Kryetarin e Komunës. Gjatë vizitave sistematike nëpër shkolla, drejtori i shëndetësisë dhe kryetari kanë marrë pjesë në aktivitetet në terren.

Në muajin maj, është përuruar donacion me paisje mjekësore dhe jomjekësore për QMF-në në Reqan, i dhuruar nga Ambasada e Bullgarisë.

6. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në realizimin e objektivave të përcaktuara me Planin e Punës 2025, planet dhe programet tjera zhvillimore, ligjet, vendimet, aktet tjera normative si dhe kërkesat e ndryshme të fermerëve dhe grupeve tjera.

Gjatë kësaj periudhe DBPZHR-ja ka arritur të realizojë objektivat e përcaktuara me Planin e Punës 2025, me synimin kryesor avancimin e pozitës së fermerëve, përmirësimin e kualitetit të prodhimeve dhe përpunimeve, zhvillimin e bujqësisë intensive dhe të qëndrueshme, e orientuar nga tregu dhe konkurrenca e lirë.

Objektivat e arritura:

- Shfrytëzimi efikas dhe i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe resurseve tjera natyrore;
- Rritja e prodhimit në fermë duke përmirësuar zinxhirin e vlerës;
- Rritja e mbështetjes financiare për fermat;
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht nëpërmes diversifikimit rural.

Aktivitetet kryesore:



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar dhe aktivitetet tjera që kanë qëllime jo bujqësore;
- Hartimi dhe zbatimi i Programit për Investimeve kapitale, subvencione dhe shërbime;
- Organizimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve në aplikimin e mbrojtjes së integruar sipas veprimtarive prodhuese bujqësore;
- Furnizimi me pajisje të ndryshme bujqësore varësisht prej veprimtarisë.



Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsej 156 kërkesa me shkrim nga lami të ndryshëm, prej tyre 117 janë miratuar, 24 janë në proces, 2 janë hedhur poshtë, 9 refuzuar dhe 2 pezulluar.

Ky raport paraqet të dhënat për projektet kapitale, projektet me bashkëfinancim, mallrat dhe shërbimet, si dhe kategoritë mbështetëse subvencionuese për secilën kategori.

Projektet në realizim:

- Rehabilitimi i kanaleve ujtëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese
- Ndërtimi i strehimores për qen endacak
- Rehabilitimi i rrugëve fushore



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Subvencione me bashkëfinancim në realizim:

- Ngritja e pemishteve me pemë të imta – dredhëza dhe boronicë
- Ngritja e pemishtes me pemë arnore
- Ndërtimi i stallave për bagëti të imta (dele, dhi)

Shërbime bujqësore në realizim:

- Trajtimi i qenve endacak
- Inseminimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve
- Vaksinimi kundër brucelozës

Një pjesë e pagesave për këto projekte ka përfunduar, ndërsa pjesa tjetër realizohet sipas përfundimit të punimeve.

Aktivitetet tjera:

- Janë realizuar 1,171 aplikime për fermerë për pagesa direkte për MBPZHR – AZHB-në;
- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave;
- Janë organizuar 6 trajnime me fermerë përmes projektit “Zhvillimi i zonave rurale për avancimin e shërbimeve këshilluese”;
- Mbajtja e praktikës profesionale me studentët e Universitetit “Ukshin Hoti”, dega Agrobiznes;
- Pjesëmarrja në panairë bujqësore të organizuara nga institucionet dhe shoqatat e ndryshme.

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, varësisht prej nevojës, është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

7. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me përmbyshjen e objektivave të parapara në Planin e Punës për vitin 2025, duke u fokusuar në



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

përmirësimin e infrastrukturës në zonat urbane, planifikimin strategjik të hapësirës, dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Projektet kryesore në realizim:

1. Rehabilitimi i kulmeve dhe koridoreve në objektet e banimit kolektiv

- Është përzgjedhur lista e objekteve që përfshihen në këtë projekt. Aktualisht punimet janë në fazën e ekzekutimit.
- Qëllimi është përmirësimi i kushteve të jetesës për banorët dhe përmirësimi i imazhit urban të lagjeve me ndërtesa kolektive.



2. Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK)

- Ky është një dokument strategjik me rëndësi të madhe që përcakton zhvillimin hapësinor të territorit të komunës.
- Gjatë kësaj periudhe, është përmbyllur faza e diskutimit publik për Profilin Urban, dhe procesi po vazhdon në përputhje me kornizën ligjore dhe udhëzimet administrative për planifikim hapësinor.

3. Hartimi i Planit Rregullues Urban për Zonën e Veçantë – Parku i Biznesit

- Plani rregullues për këtë zonë të rëndësishme ekonomike ka kaluar të gjitha fazat dhe është në proces të miratimit përfundimtar.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Statistika të punës për periudhën Janar – Qershor 2025

Gjendja e lëndëve në sektorin e Urbanizmit:

Përshkrimi	Numri
Lëndë të pranuar	586
Njoftime	60
Kërkesa të miratuara	228
Deklarata, vërtetime, akt-përcjellëse dhe shkresa të ndryshme	50
Kërkesa të refuzuara	33
Kërkesa të hedhura poshtë	13
Procedura të pezulluara	6
Lëndë në procedurë	181
Ekstrakte për Prevallë	0
Qasje në dokumente zyrtare	11
Ankesat e dërguara në MMPH	4

Gjendja e legalizimeve – Task Forca (Janar – Qershor 2025):



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Përshkrimi	Numri
Legalizime të përfunduara	134
Lista e pritjes	19
Lista e rrënit	0
Kërkesa në shqyrtim	154

Në përputhje me objektivat dhe prioritetet komunale, Drejtoria do të vazhdojë me angazhim të shtuar për finalizimin e projekteve në zbatim dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve urbane në gjysmën e dytë të vitit.

8. DREJTORIA E ARSIMIT

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka realizuar një sërë aktivitesh dhe projektsh të rëndësishme në përputhje me planin dinamik dhe objektivat strategjike të saj, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e cilësisë së arsimit në komunë.

Udhëheqja dhe Menaxhimi i Shkollave

- Është mbajtur trajnim 7-ditor për të gjithë drejtorët e shkollave në Prizren me programe të akredituara nga MASHTI.
- Është zhvilluar punëtori mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor me drejtues shkollash dhe këshillin e prindërve.
- Është realizuar studim profesional i gjendjes në çdo shkollë, me raporte individuale dhe komunale.
- Është bërë racionalizimi i rrjetit të klasave për menaxhim më efikas.

Mjedisi dhe Kultura Shkollore

- Ka hyrë në fuqi Strategjia për Siguri në Institucionet Arsimore.
- Ka vazhduar ndërtimi dhe pajisja e sallave të edukatës fizike dhe terreneve sportive.
- Janë përmirësuar ambientet e jashtme të shkollave për një mjedis më të përshtatshëm.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi



Mësimdhënia dhe Mësimnxënia

- Është fuqizuar modeli “komuniteti i të mësuarit së bashku”.
- Janë furnizuar shkollat me mjete TIK dhe pajisje laboratorike.
- Janë mbajtur trajnime për nxënës në IT dhe gjuhë të huaja në bashkëpunim me OJQ-të.
- Janë organizuar aktivitete jashtëkurrikulare për të nxitur angazhimin dhe cilësinë.

Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja

- Është përgatitur drafti i planit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.
- Është intensifikuar identifikimi i institucioneve parashkollore private.
- Është rritur mbështetja për fëmijët me nevoja të veçanta në bashkëpunim me Caritas, UNICEF etj.
- Janë funksionalizuar qendra të edukimit të hershëm në lagjet Bajram Curr dhe Ortakoll.
- Është promovuar multikulturalizmi përmes aktiviteteve ndërkulturore.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi



Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

- Janë organizuar trajnime për mbi 500 mësimdhënës në fushat e vlerësimit formativ, mendimit kritik dhe PIA (inst. arsimor), me programe të akredituara për licencim.

Cilësia në Arsimin Parauniversitar

- Është rritur përkrahja për aktivet profesionale dhe koordinatorët e cilësisë.
- Është intensifikuar këshillëdhënia për zbatimin e kurrikulës së re.
- Është avancuar procesi i digjitalizimit të sistemit arsimor, përfshirë furnizimin me tabela të mençura.
- Me mbështetje nga IOM, tri shkolla do të pajisen me laboratorë modernë.
- Është rritur numri i bursave në 250 (nga 170) me vlerë 700€, si dhe janë ndarë bursa speciale për fëmijët e invalidëve të luftës dhe nxënës me nevoja të veçanta.

Të Dhënat Statistikore

- Gjatë vitit shkollor 2024/2025, në institucionet publike të Komunës së Prizrenit kanë ndjekur mësimin gjithsej 25,882 nxënës, që përfshijnë të gjitha nivelet arsimore – nga edukimi i hershëm deri në shkollat e mesme të larta.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Aktivitetet kryesore:

- 7 Marsi – Organizim i programit artistik për Ditën e Mësuesit, me shpërndarje mirënjohjesh, dhuratash dhe drekë për mësime dhënësit që dolën në pension.
- Garat Komunale “Fizikanit të Ri 2025” – Mbajtja e garave për nxënësit e talentuar në fizikë.
- Testi ndërkombëtar PISA 2025 – Testim i 606 nxënësve nga 18 shkolla në Komunën e Prizrenit, me fokus në matjen e aftësive ndërdisiplinore.
- Testi i Arritshmërisë 2024-2025 – Përgatitje dhe organizim i testit, i cili u zhvillua më 28 qershor.
- Testi i Maturës 2024-2025 – Përgatitje dhe organizim i testit të maturës, i zhvilluar më 21 qershor.
- Kontrollë në shkollat e mesme të larta – Vizita dhe inspektim i dokumentacionit pedagogjik dhe administrativ.



Trajnime, punëtori dhe bashkëpunim në ekip:

- Punëtori për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor 2026-2028.
- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve.
- Takim i komisionit për komunitetin Romë – Ashkali – Egjiptian, pranë Kuvendit Komunal.
- Organizim dhe mbikëqyrje e procesit mësimor në mësimin jo formal.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Monitorim dhe kontroll i planeve të punës, proceseve edukativo-arsimore dhe funksionimit të organeve të shkollës.
- Bashkëpunim aktiv me prindër, ekipet e EPRBM (Ekipi për parandalim të braktisjes së mësimi), këshillin e prindërve dhe këshillin e nxënësve.
- Monitorim i shkollave për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Vlerësim i brendshëm i shkollave në shkallë kurrikulare dhe monitorim i progresit të nxënësve.
- Kontroll dhe vlerësim i funksionimit të mjeteve teknologjike në shkolla.

Punimet Infrastrukturore:

Njësia teknike pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) ka vazhduar me realizimin dhe planifikimin e projekteve infrastrukturore gjatë 6 muajve të parë të vitit 2025. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Përfundimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së tek Drejtoria e Financave.
- Vizita të rregullta në shkolla dhe çerdhe për verifikimin e pastërtisë, higjienës dhe evidentimin e nevojave infrastrukturore.
- Takime konsultative me operatorë ekonomikë dhe punëkryes për ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore.
- Mbikëqyrje e punimeve nga investimet kapitale në vazhdim.

Investimet kapitale të planifikuara për vitin 2025:

Janë planifikuar 27 projekte kapitale me një vlerë totale prej 2,486,873.00€. Disa nga projektet kryesore janë:

- Ndërtimi i çerdheve në lagjet Tusus, Zhur dhe Arbana në Prizren.
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore në Mazrrek (Gjergj Kastrioti Skënderbeu), Krushë të Vogël, anekse shkollash në Vërmicë dhe Lutogllavë.
- Renovimi i objekteve shkollore si SHF "Lekë Dukagjini", SHMU "Mati Logoreci", nyjeve sanitare dhe sallave të edukatës fizike në disa shkolla.
- Punime në terrenin sportiv dhe rrethojën e oborreve të shkollave.
- Digjitalizimi i sistemeve në disa institucione arsimore.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Deri më 31 maj 2025, është realizuar 34.22% e vlerës së përgjithshme të projekteve, ose rreth 851,066.61€ në pagesa.

Gjithashtu, vazhdojnë punimet dhe kontratat nga vitet e kaluara, si:

- Hartimi i projekteve për nevojat e DKA-së (90% i realizuar).
- Mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes qendrore (100% i realizuar).
- Punime për lyerjen e fasadave të institucioneve arsimore (5% i realizuar, me vështirësi për shkak të mungesës së buxhetit).

Menaxhimi financave:

- Në fillim të vitit 2025, është përgatitur plani i zotimeve dhe shpenzimeve për pagat dhe shërbimet komunale, të cilat janë dërguar dhe komunikuar me shkollat.
- Janë realizuar 616 zotime për të gjitha kategoritë e shpenzimeve dhe janë përgatitur raporte periodike për shkollat mbi buxhetin dhe shpenzimet.
- Janë përpunuar ndryshimet në listat e pagave për periudhën janar–maj 2025, ku për këtë periudhë janë procesuar gjithsej 712 lëndë.
- DKA ka hasur vështirësi në sistemimin në kohë të punonjësve të rinj për shkak të reduktimit të numrit të vendeve në buxhetin e vitit 2025. Aktualisht, 42 punonjës të rinj nuk janë sistemuar në listat e pagave, duke krijuar vonesa në pagesa.
- Janë realizuar pagesa me vendime gjyqësore mbi 2.5 milionë euro, ku mjetet janë marrë nga kategori të tjera buxhetore të komunës, ndërsa nga programet e arsimit janë ekzekutuar 8,276€ nga të hyrat e çerdheve.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar sipas kategorive:
 - Arsimi parafillor: 27.2% e mjeteve të ndara.
 - Arsimi fillor: 37%.
 - Arsimi i mesëm: 37.8%.
- Në total, Drejtoria e Arsimit ka shpenzuar deri tani 58.9% të buxhetit të ndarë nga granti.

9. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Projektet e kryera dhe në vazhdimësi:



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi



1. Fillimi i punimeve për ndërtimin e objekteve kulturore, rinore dhe sportive.
2. Vazhdimi i ndërtimit të qendrës kulturore në fshatin Pousk.
3. Proces i vazhdueshëm i inventarizimit të objekteve kulturore, rinore dhe sportive, me furnizimin paralel të materialeve të nevojshme.
4. Përfundimi i pagesave të mbështetjes subvencionuese të mbetura nga viti 2024 brenda tremujorit të parë.
5. Fillimi zyrtar i punimeve për renovimin e Bibliotekës së Qytetit të Prizrenit pas përfundimit të vlerësimit të tenderit.
6. Punimet në Sallën Multifunkionale janë në fazën përfundimtare.
7. Vazhdimi i mbikëqyrjes së projekteve kapitale në përputhje me investimet.
8. Punimet në Qendrën Turke janë në zhvillim e sipër.
9. Përfundimi i procedurave tenderuese për renovimin e Qendrës Sportive “Sezai Surroi” (izolimi i jashtëm dhe dritaret); fillimi i punimeve pritet së shpejti.
10. Projekti i restaurimit të Kullës në Gjonaj është në fazën përfundimtare.
11. Fillimi i punimeve për renovimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur.
12. Nisja e procedurave për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Piranë.
13. Nisja e procedurave për ndërtimin e Sallës së Mundjes në Tusuz.
14. Nisja e procedurave për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qendrën Sportive.
15. Kryerja e barkodimit të disa aseteve të inventarizimit në DKRS.
16. Vazhdimi i monitorimit të OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive sipas planifikimit.
17. Përfundimi i fazës së parë të mbështetjes financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive me vlerë totale prej 1,340,800 €.
18. Vazhdimi i pagesave për marrëveshjen me eko-regjionin.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

19. Organizimi i festës për 17 shkurtin – përvjetori i pavarësisë së Kosovës.
20. Organizimi i festivalit për fëmijë “Fluturat 2025” më 1 Qershor.
21. Organizimi i Festivalit Folklorik për Fëmijë “URA 2025” më 8 dhe 9 Qershor.
22. Organizimi i festave për 10 Qershorin (LSHP) dhe 12 Qershorin (Dita e Çlirimit të Prizrenit) – në format të ngjashëm.





Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

10.DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Ky raport pasqyron aktivitetet e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit për periudhën Janar–Qershor 2025. Raporti përfshin punën e Drejtorisë dhe institucioneve nën përkujdesjen e saj, si Qendra për Punë Sociale, Qendra Rezidenciale dhe Shtëpia për të Moshuar. Gjatë kësaj periudhe janë përballur sfida si ndryshimet ligjore, mungesa e stafit dhe buxheti i kufizuar, por janë arritur rezultate në përmirësimin e mirëqenies sociale.

Projektet Kryesore

- Ndërtimi i banesave sociale në Lagjen Petrovë (Kulla 3 dhe 4) vazhdon sipas planit.
- Furnizim me inventar për Shtëpinë e të Moshuarve është në fazë tenderimi.
- Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2) është në përfundim.
- Projektet e ndërtimit të kulmeve për familjet në nevojë dhe shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve kanë nisur ose janë në fazë tenderimi.
- Furnizime për shtëpitë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara vijnë.
- Mbulohen shpenzimet e varrimit për qytetarët në bashkëpunim me institucionet përkatëse.





Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Subvencionet

- Mbështetje për 21 OJQ në fushën sociale me mbi 100,000 Euro.
- Pagesa për familjet strehuese dhe ato në vështirësi ekonomike për qira.
- Program mbështetje për nënat që kanë lindur në vitin 2024, ku janë paguar 645 familje.

Memorandume Bashkëpunimi

- Vazhdojnë projektet me Terres des Hommes dhe OJQ Concordia për mbrojtjen dhe fuqizimin e komuniteteve në nevojë.

Qendra për Punë Sociale

Ofron shërbime sociale profesionale, duke mbështetur viktimat e dhunës, trafikimit dhe familjeve në nevojë. Gjatë Janar-Maj 2025 janë verifikuar dhe vlerësuar mbi 2,500 raste të reja, dhe 596 familje me 2,031 anëtarë përfitojnë nga skema e asistencës sociale.

11.DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik ka vazhduar me angazhime të shumta për zhvillimin dhe promovimin e potencialeve turistike të komunës sonë. Me investime strategjike në infrastrukturë, mbështetje për zanatet tradicionale dhe pjesëmarrje aktive në panaire lokale dhe ndërkombëtare, synojmë të fuqizojmë turizmin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social në rajonin tonë. Ky raport përmbledh arritjet, investimet dhe aktivitetet kryesore të kësaj periudhe.

Projektet e përfunduara dhe investimet kryesore:

- Fshati Poslisht: Përrurimi më 14 maj 2025 i destinacionit të ri turistik, me qëllim promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale.
- Rrugët në Skorobisht: Hapje dhe përrurim më 21 maj 2025 i rrugës 1.2 km për të përmirësuar infrastrukturën turistike dhe jetesën e banorëve.
- Objekti administrativ për zejtarët Esnaf: Fillimi i ndërtimit më 21 mars 2025 për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe trajnimeve lokale.
- Investime në Gurrin e Kallugjerit: Vazhdon hapja e rrugëve malore për lidhjen e fshatrave Jeshkovë, Billushë dhe Opojë.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Fshati Vlashnje: Nënshkrimi i kontratës për hapjen e rrugës malore drejt Murrademit; punimet pritet të fillojnë së shpejti.
- Fshati Zhur: Kontratë për vazhdimin e rrugës ekzistuese me qëllim lidhjen dhe promovimin e pamjeve të qytetit.
- Fshati Vërmicë: Investime në rregullimin e dy burimeve të ujit; përfundimi pritet në dy muaj, duke krijuar destinacion turistik të ri.



Aktivitetet kryesore:

- Trajnime profesionale: Janë trajnuar falas 48 persona në prill në disa fusha si modelim, qëndisje, punë me dru dhe dekorime.
- Zhvillimi i zejeve tradicionale: Trajnime në filigran, një zanat tradicional i Prizrenit, për rreth 30 të rinj dhe të reja.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi



- PanaiRET:
 - Organizim dhe mbështetje për panaiRET e turizmit, përfshirë pjesëmarrje aktive në panaiRE lokale dhe ndërkombëtare.
 - Për herë të parë, Komuna e Prizrenit u promovua në panairin “Colors of the World” në Turqi, duke prezantuar potencialet turistike në nivel global.



12. DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRIT



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Janë pranuar gjithsej **10,732 kërkesa** për shërbime të ndryshme (kontrata shitblerjeje, dhurimi, aktgjykime, lista poseduese, ndarje dhe bashkime parcelash, regjistrime objekte, etj.).

- Statusi i kërkesave:
 - 9,419 kërkesa të miratuara
 - 1,085 në proces
 - 142 refuzuar
 - 60 pezulluar
 - 19 të anuluar për arsye teknike
- Të hyrat e grumbulluara nga këto shërbime janë **127,092 euro**, që përbën rreth **27.04%** të të hyrave të drejtorisë.
- Ulja e të hyrave në periudhën në fjalë lidhet me ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nga AKK në qershor, ku u ulën tarifat kadastrale.

Aktivitete kryesore:

- Legalizimi: Janë regjistruar 134 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit për ndërtimet pa leje, të cilat tani janë të evidentuara në regjistrat kadastralë me certifikata prone.
- Piketimet: Kryerje e piketimeve për rrugë, objekte komunale dhe hapësira publike sipas kërkesave të drejtorive.
- Matjet gjeodezike: Realizim i matjeve në terren për incizime të gjendjeve faktike dhe projekte sipas kërkesave të drejtorive përkatëse.

Në përgjithësi, sektori ka funksionuar me sukses duke përmbushur kërkesat dhe realizuar aktivitete të rëndësishme për evidencën kadastrale dhe urbanistike.